

ZRrE-së, Prishtine

Nga OJQ KONSUMATORI, Prishtine,

[ok.kosova@gmail.com](mailto:ok.kosova@gmail.com)

044/200-458

Lënda: KUNDERSHTIMI I NGRITJES SE ÇMIMIT TE ENERGIJISE ELEKTRIKE NGA KEK-U

KEK ka aplikuar prane ZRrE-së për tarifa të reja të energjisë elektrike për vitin 2010, që është një procedure e rregulltë por jo edhe e domosdoshme nëse nuk ka arsye që dukshëm ndikojnë dhe imponojnë tarifa të reja.

OJQ KONSUMATORI, Prishtinë mendon se KEK nuk ka arsye dhe se nuk ka rrethana të reja që e imponojnë ngritjen e çmimit të energjisë elektrike. Eshtë e kundërta, kemi elemente që kërkojnë zbritjen e çmimit të energjisë elektrike.

Se nuk ka rrethana të arsyeshme e as motive për ngritjen e çmimeve e dëshmon edhe vet KEK-u :

-Në dokumentin e kërkesës dhe arsyetimit të aplikacionit me manipulimin e shifrave që për ne është vepër që kërkon hetime serioze disiplinore e ligjore dhe mendojmë se ZRrE, që e ka konstatuar këtë manipulim , duhet t ia paraqes rastin komisioneve disiplinore brenda KEK-ut dhe organeve hetuese.

-Në gjendjen e inkasimeve ku shihet qarte se KEK ka akoma shumë për të bërë në këtë fushë. Është absurd ekonomik dhe nonsens menaxherial të kërkohej ngritje e çmimeve të energjisë elektrike duke e arsyetuar me humbje të mëdha e ekonomizim negative - e në anën tjetër nuk inkasohen borxhet që kanë arritur deri në 400 milione €.

-Në mënyrën e trajtimit të konsumatorit pagues të rregulltë I cili, edhe kësaj rradhe, tentohet të detyrohet t i paguaj edhe borxhet e huaja, edhe përtacinë, edhe pa-aftësinë menaxheriale, edhe...

-Në politika e strategji të gabuara të menaxhimit, si q dëshmon rasti me anën veriore të Kosovës, e cila është shkëputur nga sistemi I KEK dhe tani tentohet të nxjerret kompensimi nga konsumtorët e dëgjueshëm.

-Në humbjet /rrjedhjet enorme të energjisë elektrike që dëshmon bindshëm se manxhmenti I tanishëm nuk është I aftë, I vëmendshëm e as përkushtuar për zgjedhjen e problemeve, por edhe dëshmohet si nikoqir I papërgjegjshëm.

-Në vjedhjet që poashtu, dëshmojnë " tipare " të pa-aftësisë dhe mungesës së përkushtimit të KEK-ut për parandalimin e krijimit të problemit, duke ia ngarkuar tërë barren konsumatorëve pagues të rregulltë, ja arkës së Shtetit që poashtu gjenerohet nga konsumator I taksapagues. KEK-u është përgjegjës I drejtepërdrejtë që është shtresuar mospagesa sepse, pas luftës, nga KEK-u , nga disa " aktivistë " të partive politike dhe të shoqatave humanitare doli këshilla për t mos paguar rryma " sepsa do të na e paguajnë me donacion ( sicc?!).

-Në importin e ener gjisë elektrike që nuk I destinohet konsumatorëve pagues të rregullt por për " mbulimin " e rrjedhjeve, vjedhjeve, tolerimin e mospagesës, " profesionalizmit të lartë e përkushtimit " të menaxhmentit dhe për " konsumatorët e privilegjuar "?!  
KEK-u vazhdon të importojë energji të shtrenjte elektrike duke dëmtuar arkën e shtetit dhe xhepin e

konsumatorit. Me gjithë këto investime, subvencione shtetërore, donacione e kontribute do të kryheshin investime të reja, do të kalohej ne prodhimin e energjisë alternative, do të realizohej projekti i digjitalizimit të njehsorëve.

–Në trajtimin jodinjitoz të konsumatorëve pagues të rregullt të energjisë elektrike duke i furnizuar për 1/3 më pak të nevojave ( si rasti i trafos në Vallq, në anën veriore të Mitrovicës).

–Në koston shumë të ultë të inputeve. KEK-u nuk paguan asgjë për eksploatimin e linjtit, as për sipërfaqet eksploatuese të degraduara e as për ambijentin e ndotur?!

–Në dështimin e qëllimshëm të aplikimit të njehsorëve digjital. KEK-u ofron arsyetim qesharak për koston e lartë të këtyre njehsorëve të cilët kanë kosto qesharake në krahasim me borxhin e trashur me vite prej 400 milione €?!

Ndërsa, nga ana tjetër, Konsumatori ka kontrate individuale me KEK-un për furnizim te rregulltë e në kontinuitet, për furnizim cilësor e sasior, për furnizim të sigurtë e të garantuar me energji elektrike. Ndoshta të gjitha këto në këtë formë e taksativisht nuk qëndrojnë në tekstin e kontratës. Por, ne e imagjinojmë kështu sepse Ligji për mbrojtjen e konsumatorit, ligjet tjera komparative dhe ligjet udhëzuese e determinuese për obligimet dhe te drejtat e KEK-ut këtë e thonë. Pse kjo nuk qëndron kështu në kontratë është rrethanë për të cilën duhet diskutuar e ndoshta edhe ndjekur me norma disiplinore e me ligje. Kur jemi te kontrata le ta themi hapur se as:

-Plani ABC i redukimeve nuk është paraparë në kontratë. Si i tillë ky Plan konsiderohet prishje e njeanshme e Kontratës nga KEK-u. Ky plan shkel të drejtat dhe intereset e konsumatorit si dhe indinjon rëndë ate.

-Çkyqjet (dënimet, gjobitjet )kolektive që i aplikon KEK-u në emër të inkasimit ( të dhunshëmn ) ja në emër të rritjes së shkallës së inkasimit, poashtu janë kundërligjore, ato shkelin të drejtat themelore të njeriut dhe të konsumatorit, janë diskriminuese dhe si të tilla nuk janë paraparë me kontratë?! Nëse vetëm një konsumator i një lagjeje është pagues i rregulltë i energjisë elektrike KEK-u është i obliguar të jetë i kujdesëshëm: TE PAKTËN DUHET TË GJEJ ZGJEDHJE PËR KONSUMATORIN PAGUES TË RREGULLTË dhe t ia kompensojë të gjitha dëmet. Ky koncept, ky obligim i KEK-ut nuk njihet ose ( qëllimisht ) nuk aplikohet ?!

KEK-u dëshmohej si diskriminues i konsumatorit jo vetëm me çkyqjet e konsumatorit pagues për shkak të atij që nuk paguan. KEK-u diskriminon edhe mbi baza nacionale, fetare, gjinore, profesionale e shtresore?! KEK-u shumë keq imponohet si monopolist!

-Bllok veprimi/bllok tarifë që është një deriqkë e madhe për rritjen e çmimit të energjisë elektrike, poashtu, është element diskriminues e diferencues për konsumatorin. Logjika e mirë e tregut të lirë dhe i veprimit të vlerave konkurruese shpërblen, nxitë e përkrahë konsumin duke ofruar favore e benefite. Blloka tarifa dënon dhe mundëson manipulime!

-Faturat janë të pakuptueshme edhe për konsumatorët më të informuar. Ky “ mal i paprerë “ me shkathtësi fsheh bllok tarifën dhe tarifat tjera?!

KEK-u dëshmohej shpërfillës dhe harron se:

-Me këtë formë veprimi KEK-u dëmton edhe bizneset dhe ndikon në uljen e shkallës së zhvillimit, në uljen e tempos së hapjes së vendeve të punës, në uljen e konkurrueshmërise si në tregun e brendshëm

ashtu edhe në ate të jashtëm, në rritjen e shpenzimeve jo vetëm në biznes por edhe në arsim, shëndetësi, transport, ngrohje...

–Ndikon negativisht me mosdhenien e mundesise bizneseve dhe insitucioneve e ndërmarrjeve publike me interese të lartë ose të veçantë për t u klasifikuar si KONSUMATOR I PRIVILGJUAR, si TREPÇA, SHARR CEM, FERONIKELI, BIRRA PEJA etj., të cilëve nuk iu “ kamuflohet “ fatura me bllok tarifa e marifete tjera.

-KEK-u ka ulur vlerën dhe autoritetin para kompanive te sigurimit te cilat nuk pranojne ta sigurojne as t i japin mbeshtetje te risigurimit për konsumatorët e dëmtuar për shkak të keqmenaxhimit.

–Me fshehjen e donacioneve, investimeve, subvencioneve e ndihmave tjera që jipen në përfitim të konsumatorit e jo në përfitim të KEK-ut, kontribute këto që KEK-u ( edhe këasj rradhe ) i fsheh vazhdimisht prishë imazhin e vet para konsumatorëve e më gjërë.

Gjithëmonë duhet ta kemi parasysh dhe të jemi të përgjegjshëm se ngritjet e çmimeve të energjisë elektrike kanë inicuar dhe do të iniconin ngritjen zingjirore të çmimeve të të gjitha produkteve, mallrave e shërbimeve, uljen e standardit, uljen e konkurrueshmërisë së biznesit dhe këthimin mbrapsht të proceseve të zhvillimit ekonomik.

Gjendja socio-ekonomike dhe e standardit në Kosovë nuk e përballon edhe një ngritje të energjisë elektrike. KEK-u egoist nuk mendon dhe as që është i përgaditur të marrë përgjegjësinë nëse do të zgjeroheshin shprehjet publike të pakënaqësisë së qytetarëve e, të konsumatorëve-edhe ate në këtë moment kritik kur kaloi vala e parë e manifestimit “të pakënaqësisë dhe pritet vala “tradicionale “ e protestave pranverore. Këto pakënaqësi kanë goditur edhe KEK-un që dëshmon përpjekjet e reja të KEK-ut për eksportimin e problemeve.

ZrRE me siguri e ka pasayshë se edhe interferimi i problemeve, si çështje e standardit të ulët të popullatës, është një nga faktorët determinues. Mungesa e kapaciteteve të mjaftueshme të ngrohjeve qendrore, mosfunktionimi i disave dhe mungesa e lëndëve djegëse ne një rën anë, e në anën tjetër vonesa e realizimit të mega projektit të ngrohjes qendrore për Prishtinën nga Obiliqi dhe e Mitrovicës nga TREPÇA ngarkon së tepërmi KEK-un, konsumatorin dhe arkën shtetërore.

Mbi 18% e popullatës jeton në varfëri të skajshme e mbi 40% jeton në varfëri ndërsa pjesa tjetër paguan ose interferon me arsyet tjera. Ndaj, KEK-ut i nevojitet ndërdisiplinartet në veprim, njësoj si Qeverisë së Kosovës, i nevojitet ta njoh momentin socio-historik dhe psikologjinë e re të konsumatorit për të prodhuar një qasje adekuate në shërbim të inkasimit të produktit të vet.

Vlerësimet tuaja ( të ZrRE O) parakualifikuese lidhur me aplikimin e KEK qe me shumë është bërë në saje të inercionit se sa nevojës, na inkurajojnë dhe ngrisin besimin te ju. Ndaj,

- 1.Shpresojmë se kësaj rradhe do t i rrezistoni denjësisht presioneve, qofshin ato edhe politike, dhe t i parapengoni të gjitha pasojat e mundshme. Shpresojme, besojmë dhe insistojmë që mos të ketë ngritje të çmimeve të energjisë elektrike në bazë të kërkesës së KEK.
2. Kërkojmë që të hiqet bllok tarifa si e panevojshme dhe e pa-arsyetuar deri më tani.
3. Kërkojmë të ndërpriten çkyqjet kolektive.
4. Kërkojmë anulimin e Planit ABC.
5. Kërkojmë shumë përkushtim në inkasimin e faturave.
- 6.Kërkojmë standarde në prodhimin dhe plasmanin e energjisë elektrike, si q janë: sasia, kontinuiteti,

çmimi, cilësia, dhe garantimi i tyre duke ia njohur të drejtën konsumatorit në reklamacion dhe kompensim të dëmeve.

7. Kërkojmë riformulimin e kontratës dhe marrjen parasyshtë të kërkesave tona në te.

8. Ofrohemi që , së bashku me ZrrE-në, të bëjmë arbitrazhe të nevojshme që disa kërkesa të konsumatorëve mos të kalojnë ne Gjyq.

9. Ofrohemi që, duke zbatuar maksimën tone OFROHEMI QË NË PARTNERITET T I IDENTIFIKOJMË E ZGJEDHIM PROBLEMET, së bashku të kërkojmë, gjejmë e zbatojmë zgjedhje të mira për të gjitha palët.

Shpresojmë se KUNDËRSHTIMI i OJQ KONSUMATORI do të mirepritet dhe se kërkesat tona do të gjejnë zbatim.

Përshëndetje e suksese.

05,.03.2010

Prishtinë

OJQ KONSUMATORI

Selatin Kaçaniku, kryetar,